



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY
 Nr. Prot. Br. Prot. Prot No. 03-03/765/17
 Dep. DPK
 Nr. I faq.
 Broj stranica 03 Datum 17-03-2017
 Nr. pages
 Data
 PRISHTINË

DATË/A:	16/03/2017
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	z. Artan FEJZA Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit në Ministrinë e Administratës Publike
CC:	z. Artan BERISHA Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Administratës Publike
NGA/OD/FROM:	<i>u për:</i> Shaip HAVOLLI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " Larja e veturave për nevoja të MAP-it "

I nderuari z. Fejza,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin " **Larja e veturave për nevoja të MAP-it** " me numër prokurimi: 202 17 41 221, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " **Larja e veturave për nevoja të MAP-it** " me numër prokurimi: 202 17 41 221, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

A r s y e t i m i

Departamenti i Prokurimit në Ministrinë e Administratës Publike ka përgatitë Njoftimin për Kontratë me titull " **Larja e veturave për nevoja të MAP-it** " me numër prokurimi: 202 17 41 221, e cila është publikuar në faqen elektronike të Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik me dt. 26.01.2016, në Procedurë të Hapur

Sipas detyrës zyrtare Agjencia kundër Korrupsionit, njofton Autoritetin Kontraktues- Ministria e Administratës Publike se do të jetë pjesë e vëzhgimit në ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave për aktivitetin e Prokurimit: " **Larja e veturave për nevoja të MAP-it** ".

Autoriteti Kontraktues Ministria e Administratës Publike e ka njoftuar Agjencinë për kohën dhe vendin e vlerësimit të ofertave dhe me këtë rast Agjencia Kundër Korrupsionit ka marrë pjesë në cilësinë e monitoruesit në procesin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave për këtë aktivitetin të Prokurimit më datë 24/02/2017.

Agjencia pasi ka trajtuar dokumentet në dispozicion dhe ka marrë pjesë në monitorimin rreth vlerësimit të tenderëve ka konstatuar faktet si në vijim:

Gjatë monitorimit të komisionit vlerësues AKK konstaton se për këtë aktivitet të prokurimit Dosjen e Tenderit e kanë tërhequr gjithsej 9 Operatorë Ekonomik ndërsa dosjet e tyre i kanë dorëzuar vetëm 4 prej tyre.

Komisioni për ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e tenderëve, pas vlerësimit të ofertave ka konstatuar se 4 nga ofertat e pranuar asnjëra nga këto nuk ka plotësuar kërkesat e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit dhe nuk janë të përgjegjshme.

Më datë 09/03/2017 Autoriteti Kontraktues- MAP përmes postës elektronike ka njoftuar Agjencinë se komisioni vlerësues ka hartuar raportin e vlerësimit për aktivitetin e prokurimit "Larja e veturave për nevojat e MAP-it" me numër të prokurimit 202/17/008/221, AK do të bëjë anulimin e aktivitetit pasi që asnjë nga OE nuk i plotëson kriteret sipas njoftimit për kontratë dhe Dosjes së Tenderit.

Gjatë shfletimit të dosjes së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit Agjencia ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues në Njoftimin për Kontratë të publikuar në faqen elektronike të KRPP-së, më datë 26/01/2017, tek rubrika III.2.4 e rubrikës "Kapaciteti teknik dhe profesional", pika c) është kërkuar: Largësia e vendit maksimum 2km nga Objekti i Rilindjes, dëshmia e kërkuar dokumentare: Adresa e saktë e objektit jo më lag se 2 km nga Ndërtesa e Rilindjes, gjithashtu e njëjta pikë është përshkruar edhe në Dosjen e Tenderit , që ka përgatitur A.K për këtë tender , pikë kjo e cila konsiderojmë se bie ndesh me ligjin në fuqi për Prokurimin Publik.

Autoriteti Kontraktues Ministria e Administratës Publike me formulimin e këtij kriteri tek pika c e Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit, ka bërë Diskriminim territorial në kundërshtim me Ligjin në fuqi për Prokurimin Publik ku thuhet se "Autoriteti Kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose

organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik“, duke i diskriminuar Operatorët Ekonomik që janë në largësi më tepër se 2 km favorizohen Operatorët Ekonomik që janë më afër se 2 km.

Gjatë shfletimit të Raportit Vlerësues të përgatitur nga ana e komisionit vlerësues më datë 08/03/2017, Agjencia ka konstatuar se kriteri i cekur si më lartë ka qenë edhe arsyeja e Anulimit të këtij Aktiviteti të Prokurimit ngaqë Operatori i vetëm i cili ka plotësuar të gjitha kërkesat e kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratën është eliminuar sepse nuk ka plotësuar kriterin e largësisë së kilometrave .

Veprimet e Autoritetit Kontraktues të cekura më lartë, konsiderojmë se bien ndesh me Nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042 , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !